



---

RAPORT I KONFERENCËS VJETORE

---

# *Si të mendojmë kulturalisht?*

---

Dhjetor 2014, Prishtinë





Rrjeti i organizatave të pavarura  
të kulturës të Kosovës  
[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)

---

RAPORT I KONFERENCËS VJETORE

# *Si të mendojmë kulturalisht?*

---

Autore: **Zana Sokoli**



Projekt i financuar nga BE-ja  
dhe i menaxhuar nga Zyra e  
Bashkimit Europian në Kosovë



Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme Internacional Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

*“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”*

# Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të paraqesë në mënyrë të përgjithësuar diskutimet, të gjeturat dhe rekomandimet e dala nga konferenca vjetore e Forumit Kulturor, mbajtur më **3 dhjetor 2014**, në sallën e konferencave **ORION** (përballë Kino ABC në qendër), në Prishtinë.

Konferenca ‘Si të mendojmë kulturalisht’ bëri bashkë panelistë të shquar nga vendi dhe rajoni, me idenë bazë për të vënë në qendër të vëmendjes kulturën dhe trajtimin që e merr ajo nga shteti. Konferenca mëntonte gjithashtu të paraqiste të përmbledhur gjithë aktivitetin vjetor të forumit dhe të sjellë shembuj përtej kufijve, për t’i shfrytëzuar më pas si rekomandime dhe strategji që do të ndikojnë në zhvillimin e jetës kulturore në Kosovë. Diskutimet në këtë konferencë u zhvilluan në dy panele dhe në të dyja rastet është vënë theks i veçantë te roli që ka shteti dhe qasja e dy niveleve të qeverisjes në sektorin e kulturës. Paneli i parë kishte në fokus numrat dhe rëndësinë që paraqesin ato për kulturën, kurse në panelin e dytë u diskutuan politikat dhe strategjitë lokale, subvencionet, aktivitetet dhe në përgjithësi trajtimin që merr kultura në nivel komunal.

Pas publikimeve dhe raporteve të Forumit Kulturor gjatë vitit 2014 dhe të të gjeturës kryesore që tregon se ndarja buxhetore për kulturën është më pak se 1 për qind nga buxheti i përgjithshëm shtetëror i Republikës së Kosovës, panelistët e parë u fokusuan në ndikimin që kanë apo jo këta numra në kulturë. Përderisa për Ministrin e Kulturës numrat nuk janë matës real të nivelit dhe nuk flasin realisht për vlerat në kulturë, në anën tjetër aktivisti kulturor nga Zagrebi konsideron se në vendet siç janë shtetet e rajonit ku nuk ka politika të qarta kulturore dhe prioritete, atëherë e vetmja mënyrë për të parë se si shteti e trajton kulturën është përmes financimit që i bën asaj. Hulumtuesi Dren Pozhegu problemin kryesor e sheh tek mungesa e strategjisë për kulturën. Ai konsideron se përderisa nuk ka bazament dhe standard është vështirë të bëhet matja e performancës, qoftë e ministrisë qoftë e buxhetit. E kur jemi te linjat buxhetore edhe diskutuesi i këtij paneli nga Instituti GAP, deklaroi se është problem të dihet se sa prej buxhetit të shtetit shkon për aktivitete kulturore pikërisht për faktin që në momentin kur bëhet planifikimi, por edhe shpenzimi nuk janë të ndara qartë në vija buxhetore. Ai është i mendimit se të dy nivelet, qoftë ai qendror apo ai komunal, kanë mungesë prioritetesh në sektorin kulturor.

Përvojën nga Shqipëria e solli themeluesi i Skenës së Pavarur Kulturore të Shqipërisë, Andi Tepelena, i cili theksoi se problemi që kemi me numrat është në fakt problem kombëtar dhe vjen edhe si pasojë e një mentaliteti centralist që e kemi të trashëguar nga sistemi komunist. Ai e sheh si problem fenomenin ‘financim pikator’, duke mos krijuar financim për sektorin në mungesë të ligjit që do të përcaktonte shpërndarjen e buxhetit në nivel lokal.

Drejtori artistik i DokuFestit, Nurkollari, u shpreh i bindur që komuniteti kulturor duke pasur më shumë vetëbesim, duke krijuar modalitete dhe prioritete të përbashkëta mund të arrijë që kulturën ta ngrejë mbi nevojat elementare. Ai parapëlqeu që ta marrë DokuFestin si shembull për të treguar se ndonjëherë jo gjithçka varet nga shteti.

**Në panelin e dytë** fokusi ishte te subvencionimet kulturore në nivel komunal, politikat kulturore dhe roli që ato kanë për qytetin dhe komunitetin. U sollën shembuj konkret nga Komuna e Prishtinës në përpjekje për ta ndryshuar trajtimin joadekuat që i është bërë komunës siç thanë ata nga administrata e kaluar. Ajo që vlen të përmendet është ndarja e Drejtorisë së Kulturës,

Rinisë dhe Sportit në Drejtori të Kulturës dhe atë të Sportit, e me këtë ndarje edhe ndarja e shumë buxhetore për kulturën në kategori të ndryshme si për sponsorizimin e institucioneve komunale, botime të ndryshme, për sponsorizimin e institucioneve të pavarura kulturore, arte vizuale dhe ekspozita, manifestime e organizime, për muzikë, film dhe teatër. Qëllimi kryesor i kësaj politike të re është jetë promovimi i secilit nga këta sektor kulturore. Gjithashtu u theksua se për herë të parë në Prishtinë është marrë një vendim ku është krijuar një komision i jashtëm në të cilin bëjnë pjesë edhe dy zyrtarë të komunës, i cili merret me vlerësimin e projekteve. Përtej Prishtinës që po kalon në një fazë të përpjekjeve për të ndryshuar politikëbërjen, në përgjithësi mungesa e strategjive dhe prioriteteve kulturore në përgjithësi i karakterizon edhe komunat, pra nivelin lokal të qeverisjes. Megjithatë u përmend qyteti i Prizrenit për politika të avancuara, atje kanë drejtori për turizëm, Prizreni kulturën e sheh si më multidiplinare, një pjesë e përkrahjes së aktiviteteve kulturore vjen edhe prej drejtorisë së turizmit. Në Pejë është Rrjeti i Organizatave të Kulturës që ka hartuar një deklaratë bashkëpunimi me komunën dhe se disa nga pikat e saj kanë qenë përpilimi i strategjisë kulturore si dhe plani i veprimit të drejtoratit të kulturës,

kalendari kulturor i qytetit të Pejës, përcaktimi i kritereve dhe komisioneve për grantet për organizatat e kulturës, rritja e buxhetit kulturor për skenën e pavarur si dhe hartimi i politikave kulturore për zhvillimin e turizmit kulturor.

Përvoja nga rajoni u soll nga aktivistët e dy vendeve fqinje, Sllovenisë dhe Maqedonisë. Sllovenia është vendi i cili karakterizohet për struktura qeverisëse jashtëzakonisht të centralizuara. Komunitat atje janë të fragmentuara dhe me shumë pak kompetenca vendimmarrëse, nuk kanë linja të ndara buxhetore dhe përkrahja që i ndahet zakonisht iniciativave të pavarura është simbolike. Institucionet e pavarura kulturore sllovene kanë tashmë përkrahje financiare permanente që konsiderohet sukses në raport me shtetet e rajonit. Ajo në të cilën stagnon aktualisht skena kulturore sllovene u tha të jetë mungesa e kooperimit regjional. Si shembull i keq nga Maqedonia u përmend humbja e luftës së komunitetit kulturor maqedonas ndaj strategjisë Shkupi 2014. Komuniteti kulturor u porositi të jetë më i bashkuar dhe proaktiv, të jenë katalizator të shtyrjes përpara të proceseve të rëndësishme për vendin dhe të promovojnë gjithëpërfshirje sociale sidomos grupet e marginalizuara.

### **Bazuar në atë që është diskutuar në këtë konferencë, në vijim janë rekomandimet e raportit:**

- 1)** Krijimi i strategjisë Kombëtare të Kulturës.
- 2)** Bashkëpunimet dhe koalicionet e përbashkëta mes institucioneve të pavarura të kulturës dhe pushtetit qendror/ lokal në zhvillimin e politikave kulturore.
- 3)** Të krijohet lista e prioriteteve dhe pastaj të dihet se cilat organizata do të mbështeteshin nga Ministria e Kulturës.
- 4)** Të merret shembulli i fondacionit Kultura Nova - Fondacion Publik për Zhvillimin e Kulturës Bashkëkohore për të krijuar partneritet publiko-shoqëror në nivel institucional.
- 5)** Politikat lokale duhet të jenë pjesë integrale e zhvillimit të qytetit.
- 6)** Komuna të jenë më të hapura për të kërkuar ndihmë nga njerëz kompetentë, në përgjithësi jo vetëm në Prishtinë dhe të mos shndërrohen në operatorë kulturorë, por t'i ndjekin operatorët kulturorë dhe t'iu krijojnë hapësirë njerëzve kompetentë.

Panelet u paraprinë nga disa fjalë hyrëse nga kryetari i Forumit Kulturor, Florent Mehmeti dhe Stojan Pelko, përfaqësues i zyrës së BE-së në Kosovë. Mehmeti u fokusua kryesisht në punën që po bëhë forumi në përpjekjen e tij për të

zhvilluar politika të mirëfillta kulturore, duke theksuar se në këto dy vite aktivitet të forumit janë planifikuar të prodhohen 28 dokumente ku fjalë kyçe janë politikat kulturore. Sipas tij në përpjekjen e forumit për të ndërtuar një partneritet strukturor frytdhënës ka josingëritet të politikës e që për Mehmetin kjo përbën problem kulturor në thelb, duke deklaruar më pas se ky josingëritet ka të bëjë me pjesën e bashkëpunimit apo koalicionit për zhvillimin e politikave kulturore. Në këtë kontekst, ai shprehet i habitur se si është e mundur që një kulturë e prodhuar në Kosovë të jetë aq e vlerësuar jashtë vendit, përderisa instancat vendore pothuajse e injorojnë fare. Përkrahjet të tipit 'përkrahje morale' përveçse të pamjaftueshme si të filla, shpesh kanë ditur të ngjallin edhe dyshime te partnerët ndërkombëtarë në mungesë të pasqyrave financiare, deklaroi Mehmeti.

Në anën tjetër Pelko solli shembujt dhe mësimet që ai ka marrë gjatë mandatit të tij tre vjeçar si sekretar shteti në Ministrinë e Kulturës në Slloveni. Pelko po ashtu foli për sfidat e kulturës sllovene e cila ishte ballafaquar me rënie të buxhetit prej 20% brenda 4 vitesh. Megjithatë ai më shumë u fokusua në eksperiencat dhe mësimet e tij, të cilat i solli si shembuj konkret për t'u pasur parasysh nga shteti

dhe komuniteti kulturor në Kosovë. Qenësore edhe për të do të duhej të ishte një strukturë dhe një dialog i strukturuar në mes të pjesëmarrësve të ndryshëm të jetës kulturore, pra duke përfshirë ministrinë, OJQ-të dhe shoqëritë civile nga sektori i kulturës.

Duke u referuar fjalëve të Robert Boeman, drejtor kulture dhe trashëgimie në Këshillin Europian, Pelko ritheksoi se ajo çka aktualisht i mungon Kosovës është një platformë e strukturuar, e cila promovon shkëmbimin e ideve dhe nga ku veprime adekuate mund të merren për të shtuar dhe kombinuar përpjekje të ndryshme që për fokus kanë praktikat artistike, që kanë për qëllim të provokojnë ndryshime pozitive shoqërore në kulturë. Në vend të kombinimeve të pakoordinuara të individëve apo përpjekjeve të fragmentuara duhet të mendohet për një agjendë konkrete dhe të dihet qartë ajo për të cilën diskutohet. Vetëm në këtë mënyrë sfidat mund të kthehen në ndryshime dhe ju, duke ju drejtuar forumit dhe komunitetit kulturor, do të jeni në gjendje t'i ndryshoni ligjet, të krijoni institucione, draftoni politika dhe të debatonit.



# Çfarë flasin numrat për kulturën?

## **Ky panel kishte si fokus trajtimi këto tema:**

1) A janë me të vërtetë numrat matës të nivelit dhe përcaktues të vlerave kulturore?

2) Ndarja buxhetore për kulturën dhe shpërndarja e subvencioneve

2.1) A janë subvencionet për kulturën kompetencë ekskluzivisht e Ministrisë së Kulturës, apo edhe e ministrive tjera?

3) Mungesa e një strategjie për kulturën dhe prioriteteve për politika kulturore

4) Të tjera

Pjesëmarrës në panelin e parë ishin panelistët Memli Krasniqi, Ministër i Kulturës, Dren Pozhegu, hulumtues, Andi Tepelena nga Skena e Pavarur Kulturore e Shqipërisë, Teodor Celakoski, punëtor dhe aktivist kulturor në Zagreb si dhe diskutuesit Veton Nurkollari, Drejtor artistik i Dokufest dhe Agron Demi, Drejtor ekzekutiv i Institutit GAP. Ky panel u moderua nga gazetari Adriatik Kelmendi.

Në diskutimin kryesor të panelit se **a janë me të vërtetë numrat matës të nivelit dhe përcaktues të vlerave kulturore**, pati qëndrime, përvoja dhe argumente të ndryshme mes panelistësh që herë qëndronin në të njëjtën linjë e

herë diametralisht të kundërt. Ministri në largim i kulturës, duke mos dashur të zvogëlojë rëndësinë që numrat kanë, megjithatë deklaroi që nuk janë qendrore jo vetëm për kontekstin kosovar, por edhe në rastet kur bëhen krahasime me vendet e tjera. Sipas tij, buxheti nuk duhet vlerësuar prej përqindjes dhe në një kontekst të tillë siç është Kosova më relevante do të ishte të flitej për vlerën reale monetare të shpenzuar se sa të thuhet kemi buxhet 0,76 për qind për kulturë. Për ta ilustruar faktin që numrat jo detyrimisht përkthhen në vlera dhe nuk janë matës real të nivelit, ai solli disa shembuj të disa vendeve të BE-së që me përqindje e kanë buxhetin për kulturë edhe më të vogël se sa Kosova, si për shembull Greqia, Irlanda, Holanda, Polonia, Portugalia, Belgjika, e që kjo jo detyrimisht i bie që ne kemi kulturë më të mirë se ata. Për ta zhvendosur krahasimin në nivel kombëtar ai po ashtu bëri krahasimin e buxhetit shtetëror që i ndahet kulturës në Kosovë dhe kulturës në Shqipëri. Nëse krahasohen buxhetet e përgjithshme shtetërore të dy vendeve Shqipëria i bie të ketë buxhetin për kulturë rreth 0.5% dhe nëse shikohen akoma më afër buxhetet që u ndahen institucioneve publike të kulturës edhe aty ka dallim. Ai përmendi vlera konkrete, si për shembull, buxheti i

teatrit të Shqipërisë për tërë vitin është 12 mijë euro, teksa i teatrit të Kosovës 330 mijë euro, apo Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë ka 20 mijë euro buxhetin vjetor të projekteve kurse në Kosovë këtë vit kanë qenë 160 mijë euro. Duke aluduar në atë se megjithatë ne si pikë referente e kemi rajonin dhe nëse do të duhej të bazohemi në numra, atëherë Kosova qëndron dukshëm më mirë.

Kur jemi tek Shqipëria Tepelena deklaroi se problemet me numrat ne i kemi si komb duke thënë se as në Shqipëri s'ka pasur ndonjë analizë serioze se sa është vërtetë fondi për kulturën dhe sa shpenzohet në nivel kombëtar dhe lokal e që tregon për një mentalitet centralist që vjen nga një trashëgimi komuniste. Përtej buxhetit nga shteti, përderisa nuk ka analiza për buxhetin lokal apo edhe donatorët, është e vështirë të matet kultura përmes numrave, ritheksoi ai.

Në anën tjetër përvoja e sjellë nga Kroacia tregon se numrat kanë jashtëzakonisht rëndësi, sepse janë mjet që shërben për ta zbërthyer qëllimin e partive politike në pushtet në raport me kulturën. Përkrahja financiare e ofruar nga shteti është një nga mënyrat kryesore veçanërisht në shtetet e rajonit ku nuk ka politika të qarta kulturore,

për ta kuptuar nëse kultura është apo jo prioritet për ta.

Autori i hulumtimit "Politikat kulturore dhe ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë", potencoi se ka shumë perceptime që nuk përkojnë me numrat në kulturë. Ai vuri theksin sidomos te fakti se janë institucionet publike të kulturës ato që përfitojnë më së shumti dhe që në njëfarë mënyre i bie të jenë dorë e zgjatur e vetë ministrisë, teksa shumë pak hapësirë i servohet kulturës së pavarur.

### **Ndarja buxhetore për kulturën dhe shpërndarja e subvencioneve u**

theksua të jetë po ashtu indikator i performancës kulturore në përgjithësi. Pozhegu konsideron se përderisa nuk ka bazament dhe standard, është vështirë të bëhet matja e performancës, qoftë e ministrisë qoftë e buxhetit dhe se është po ashtu e vështirë të bëjmë krahasime aq të mëdha përderisa nuk ekziston një sistem, një strukturë, një standard mbi të cilin bazohemi. Hulumtimi i tij tregon se buxheti për kulturën nuk ka ndryshuar edhe aq shumë. Buxheti në vlera absolute është rritur, domethënë ka qenë 400 mijë është bërë 1 milion, mirëpo nëse e shohim këtë rritje proporcionalisht me rritjen e buxhetit

total të Qeverisë së Kosovës, atëherë e shohim që realisht nuk ka pasur rritje. Problemin tjetër ai e sheh edhe tek ky 0.76 për qind e buxhetit total për kulturën, sepse rreth 60-70 për qind (ka vite edhe 90) e tij shkon për institucionet publike, duke i lënë fare pak hapësirë skenës së pavarur. Në këtë hulumtim mbi buxhetin nuk janë të përfshira mjetet e ndara në nivel lokal. I pyetur në lidhje me këtë çështje Ministri i Kulturës deklaroi se në asnjë rast nuk është i pajtimit që apriori duhet thënë se institucionet publike krijojnë vlera më të mira, sepse kemi dëshmi që mund të jetë ndryshe, si për shembull rasti i DokuFestit. Por konsideron se është normale që shteti për institucionet e karakterit kombëtar ka përgjegjësi më të madhe, në një kontekst ku sektori privat e mbështet kulturën në mënyrë minore. Megjithatë ishte i pajtimit që duhet bërë reformimi i mënyrave të mbështetjes, dhe se është i vetëdijshëm se duhet të ketë përputhje në mes të inputeve dhe outputeve që këto institucione japin, sepse atëherë kur ata e dinë që i kanë mjetet e sigurta, pavarësisht produktit që sjellin, atëherë bie edhe cilësia.

Pas deklaratës së ministrit se vetëm Ministria e Kulturës i mbështet mbi 300 evente kulturore prej atyre individuale,

artistë të rinj, ekspozita për arte pamore, grante për udhëtime për ta prezantuar ose për të ndjekur ndonjë workshop jashtë vendit, festivalet dhe eventet kryesore në Kosovë, çështje tjetër e ngritur në panel ishte edhe përkrahja financiare dhe shpërndarja e subvencioneve. Në pyetjen se a është më mirë që ministria t'i mbështesë 50-70 evente, por të cilat janë më përmbajtjesore, apo 300-400, ku mundohemi ta mbulojmë aktivitetin e secilës nismë ngapak, por pa e mbështetur asnjërin sa duhet, drejtori ekzekutiv i GAP-it u shpreh që kjo ka direkt të bëjë me mungesë prioritetesh qoftë në nivel qendror qoftë lokal. Ai theksoi se përderisa secili vend në BE e ka një prioritet, a do ta financojë trashëgiminë, identitetin kulturor apo diçka tjetër edhe Kosova do të duhej të kishte prioritete të tilla e pastaj të dihej se cilat organizata do të mbështeteshin nga Ministria e Kulturës. Për ministrin është e padrejtë nëse mbështeten vetëm ato iniciativa që kanë ndikim, sepse absolutisht në këtë mënyrë përjashtohet pjesa e të rinjve, artistëve të rinj, dhe ata që janë në margjina apo në rajone, dhe kjo konsiderohet si qasje përjashtuese. Kryetari Forumit Kulturor problemin e mbështetjes e gjen pikërisht tek mungesa e krijimit të një

platforme dhe koalicioni më të gjerë që do të ndihmonte në krijimin e një strategjie orientuese të këtij sektori. Kur flet në emër të teatrit ODA deklaroi se kanë pasur mjaft halle sepse niveli i mbështetjes prej shtetit kap diku vlerat e 3-4 për qind dhe në anën tjetër ka fonde shumë më të mëdha të programeve europiane në të cilat ata participojnë.

Probleme të ngjashme hasen edhe në shtetin fqinj, Shqipërinë. Në panel u deklarua se nëse investohet në kulturë, investohet duke pasur parasysh prioritetet sektoriale të fushës, pra investohen para në sektor ku shikohen prioritetet, kalkulimet elektorale, shpesh edhe preferencat e ministrit të radhës për zhanret e caktuara, apo edhe mentaliteti klanor. Vazhdon fenomeni 'financim pikator' duke mos krijuar financim për sektorin në mungesë të ligjit që do të përcaktonte shpërndarjen e buxhetit në nivel lokal. Po ashtu edhe në Shqipëri ekziston problemi i ndarjes së buxhetit. 61 për qind e të ardhurave për kulturën shkojnë për institucionet e varura kulturore siç mund të jenë galeria, muzeumet etj; 16 për qind shkojnë për trashëgiminë kulturore dhe diku vetëm 5.1 për qind shkon për skenën e pavarur kulturore. Skena e Pavarur Kulturore atje ballafaqohet me probleme edhe atëherë

kur pranon grante dhe donacione të huaja, sepse 20 për qind të tyre duhet t'i paguajë shtetit si TVSH.

Çështje tjetër e ngritur në panel kur bëhej fjalë për përkrahjen dhe subvencionet ishte se **a do të duhej që subvencionet për kulturën të jenë kompetencë ekskluzivisht e Ministrisë së Kulturës, apo edhe e ministrive të tjera.** Kjo ngaqë në konferencë u sollën shembuj se si kultura dhe aktivitete të shumta në Kosovë ndonjëherë dinë të përkrahen më shumë nga Ministria e Integritimit Europian se sa vetë Ministria e Kulturës. Ishte përfaqësuesi nga GAP ai që deklaroi se Ministria e Integritimit Europian deri në shtator, 66 për qind të buxhetit e ka dhënë për aktivitete kulturore, duke folur madje edhe në vlera monetare. Ky fakt u cilësua brengosës edhe gjatë diskutimit të hapur ku u potencua se këto donacione nuk mund të shpërndahen pa pasur ekspertizë të nevojshme për të vlerësuar saktë se çka duhet mbështetur dhe këto ekspertiza do të duhej të realizoheshin nga Ministria e Kulturës aty ku ka njerëz të thirrur për këtë çështje. Ministri i kulturës, edhe pse nuk do të jetë në krye të kulturës në mandatin e ardhshëm qeverisës theksoi se qeveria e re për herë të parë do të ketë kapitull të veçantë për

kulturën në programin e saj qeverisë me indikator matës, duke i dhënë hapësirë komunitetit kulturor që ta thërrasë më pas në përgjegjësi. Ai deklaroi se vitin e ardhshëm nga mjetet mbi 1 milion janë të ndara te kodi për kulturën e pavarur dhe 2 milion për institucionet publike.

Shqetësuese dhe në njëfarë forme shkaktari kryesor i të gjitha problemeve me të cilat ballafaqohet sektori kulturor u konkludua të jetë mungesa e një **strategjie të përbashkët për kulturën dhe e prioritetëve të politikave kulturore**. Kjo u potencua në disa raste nga të gjithë panelistët dhe diskutuesit. Qoftë në Kosovë qoftë në Shqipëri, komuniteti kulturor do të vazhdojë të ballafaqohet me jotransparencë, me mungesë fondesh dhe përkrahje financiare, me ndarje buxheti pa pasur ekspertizë të nevojshme se çka dhe kë duhet përkrahur, me financime pikatore dhe me qasje përjashtuese e klienteliste. Përderisa në Kosovë ka kohë që kërkohet nga Forumi Kulturor nënshkrimi i një strategjie të tillë bashkëpunimi nga ana e ministrisë që do t'i paraprinte zhvillimit të politikave kulturore lokale, në anën tjetër ajo çka kërkon me ngulm skena e pavarur kulturore në Shqipëri është krijimi i një ligji që përcakton shpërndarjen e buxhetit në nivel lokal.

Mbështetja e kulturës në nivel lokal përveçse përkrah identitetin kombëtar i jep po ashtu hapësirë identitetit në nivel lokal e edhe etnik të komuniteteve. Shteti tjetër fqinj i Kosovës, Maqedonia, në anën tjetër anipse e posedon strategjinë për kulturë 2014 - 2017, realiteti dhe mënyra se si shpenzohet buxheti atje u deklarua të jetë komplet ndryshe prandaj në këtë rast inkurajohet dhe kërkohet bashkëveprim shumë më i madh në mes të pushtetit dhe komunitetit kulturor për t'i vënë në jetë kërkesat që ata kanë konform strategjisë dhe prioritetëve të dala nga bashkëveprimi i përbashkët. Vlen të përmendet që në diskutimin e hapur u përmend fakti se aktualisht ekziston një strategji bashkëpunimi në mes të shoqërive civile dhe qeverisë, teksa sipas Albert Hetës në Ministrinë e Kulturës zyrtarët e lartë nuk e dinë se ekziston ai dokument fare.

Kur jemi te përvojat nga rajoni Kroacia është vendi që mbase duhet të merret si shembull i funksionimit të komunitetit kulturor, për mënyrën se si e vë në presion shtetin duke e kontestuar në procese të ndryshme, por gjithashtu edhe për partneritetin inovativ në nivel institucional që e ka me qeverinë. Kroacia solli shembuj për forma më

të avancuara të organizimit të skenës kulturore, ku moment i rëndësishëm konsiderohet themelimi i **Kultura Nova** - Fondacion Publik për Zhvillimin e Kulturës Bashkëkohore me qëllime jofitimprurëse, e themeluar me ligj, e financuar nga fonde të ndryshme 'qëllimmira' (lottery funds) dhe POGAN- një qendër hibride kulturore e themeluar në një partneritet publik-qytetar në nivel institucional mes aktorëve nga skena e pavarur kulturore dhe qytetit të Zagrebit. Aktivisti kroat potencoi se nuk mund të flasim për logjika transversale që e sjellin kulturën në korrelacion me çështjet e tjera shoqërore në idenë e një qasjeje më integruese, përderisa nuk shkëputemi nga metodologjia tradicionale e trajtimit të saj. Prandaj në këto dhjetë vitet e fundit ajo çka ka bërë komuniteti kulturor atje ka qenë një mënyrë ndryshe e influencimit të kulturës dhe zhvillimeve shoqërore. Kur thuhet ndryshe bëhet fjalë për krijimin e një platforme gjithëpërfshirëse në përpjekje të reprezentimit të rrjetit të kulturës si diçka që jo vetëm kërkon përkrahje financiare nga shteti, por edhe e kundërshton atë fuqishëm kur vendimet që merr konsiderohen joadekuate dhe përtej kulturës prekin një shkallë më të gjerë shoqërore.

Krijimi i këtij rrjeti nacional të kulturës së pavarur ka bërë bashkë në Kroaci më se 100 organizata, të cilat kanë krijuar programe shkëmbimi mes vete. Këtë mënyrë funksionimi Cetakoski e konsideron si rrjet taktik, transdisciplinar dhe mënyrë transektoriale e përfshirjes së bartësve të tjerë të shoqërisë kulturore, duke krijuar koalicione afatmesme rreth çështjeve të ndryshme, si për shembull zhvillimeve urbane. Për ta ilustruar këtë ai solli shembuj të ndryshëm të intervenimit të tyre siç është rasti i 'luftës' së tyre rreth një sheshi publik në Kroaci, kundër procesit të privatizimit apo edhe dhënies me koncesion të autostradës. Funksionimi i tyre në këtë mënyrë u ka dhënë atyre rol të veçantë si shoqëror ashtu edhe politik. Për më tepër pas themelimit të POGAN, ky partneritet publiko-qytetar i ka bërë ata përfitues të një fondi europian (Fondi Social European) në vlerë prej 20 milionë euro për krijimin dhe mbështetjen e kësaj infrastrukture kulturore në të gjithë Kroacinë. Ndër të tjera në panel u hodh po ashtu ideja e krijimit të një portali të skenave të pavarura kulturore të të gjithë rajonit, ku do të mund të ketë trafik, shkëmbime dhe fluks informacionesh duke ndërtuar kështu edhe një strategji të përbashkët rajonale për skenën kulturore.

# Kultura komunale e mëshirës

## Ky panel kishte si fokus trajtimi këto tema:

- 1) Si subvencionohet kultura në komonat e Kosovës?
- 2) Politikat kulturore në nivel komunal dhe impakti i tyre
- 3) A duhet të jenë komonat operator kulturor?
- 4) Të tjera

Pjesëmarrës në panelin e dytë ishin panelistët Fitore Pacolli, Shefe e kabinetit të kryetarit të Prishtinës, Samo Selimović nga Bunker Institute, Lubjanë, Violeta Simjanovska nga PAC Multimedia, Shkup, Albert Heta, Drejtor ekzekutiv i Stacion CCA si dhe diskutuesi Vullnet Sanaja, Drejtor ekzekutiv i Anibar. Në panel mungoi i ftuari tjetër në rolin e diskutuesit Erson Zymeri nga Riverside. Ky panel u moderua nga Besa Luzha, Chopin Association.

Në panelin e dytë debati u zhvendos nga konteksti qendror në atë lokal, por gjithsesi u vazhdua të flitej për numrat, për linjat buxhetore, për raportin e përkrahjes mes institucioneve publike dhe atyre të pavarura, për veprime ndërsektoriale, mobilizim etj. Kur jemi te **buxheti dhe subvencionet komunale për kulturën**, është komuna e Prishtinës ajo që u deklarua ta ketë dyfishuar buxhetin për vitin 2015 sai përket kulturës. Por ajo që

vlen të theksohet është se buxheti nuk do të jetë më i përbashkët për kulturë dhe sport, por do të ndahet në buxhet për kulturën dhe buxhet për sportin. Ndryshim radikal, është ndarja e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Drejtori të Kulturës dhe atë të Sportit. Tutje, do të bëhet edhe ndarja e shumës buxhetore për kulturën në kategori të ndryshme si për sponsorizimin e institucioneve komunale, botime të ndryshme, për sponsorizimin e institucioneve të pavarura kulturore, arte vizuale dhe ekspozita, manifestime e organizime, për muzikë, film dhe teatër. Arsyeya e kësaj ndarjeje u tha të jetë promovimi i secilit nga këta sektor kulture. Në pyetjen se kush dhe si do të jetë përfitues i kësaj ndarjeje buxhetore, Pacolli tha se do të ketë thirrje të ndara për secilin sektor dhe se do të jenë të përcaktuara kriteret gjithnjë duke bashkëpunuar me organizatat përkatëse.

Komuna e Prishtinës do të ndajë për vitin 2015 për institucionet komunale 60 mijë euro përkrahje, kurse për ato të pavarura 50 mijë. Shefja e kabinetit të kryetarit të Prishtinës u shpreh se do të përkrahet zhvillimi i institucioneve komunale, por kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se mbytet konkurrenca, përkundrazi ata do të tentojnë që përmes politikave të tyre ta promovojnë atë.

Albert Hefa, autor i hulumtimit 'Për të mirë të popullsisë së komunës' tha se po të analizohet ligji atëherë buxheti ka rol sekondar, sepse mënyra se si administrohet kultura, por jo vetëm ajo në nivel lokal, bazohet krejtësisht në ligjet aktuale në fuqi. Pra ligjet i japin të drejtën kryetarit të komunës për të bërë çkado. Duke dashur të bëjë krahasimin e administratës paraprake në Prishtinë me atë aktuale, ai tha se mënyra e ndërrimit të menaxhimit të subvencioneve është ndryshim radikal. Këto subvencione deri në administratën e kaluar janë administruar prej zyrtarëve të drejtorateve komunale e në fund vendimi është marrë prej kryetarit. Për herë të parë në Prishtinë është marrë një vendim ku është krijuar një komision i jashtëm në të cilin bëjnë pjesë edhe dy zyrtarë të komunës, i cili merret me vlerësimin e projekteve. Por gjithsesi u potencua se ky veprim është bërë krejtësisht në vullnet të kryetarit të Prishtinës, por ndoshta nuk do t'i bënte ndonjë kryetar tjetër, sepse nuk janë të obliguar me ligj që të sillen në këtë mënyrë apo tjetër.

Për të përfaqësuar rrjetin e organizatave të pavarura kulturore të Pejës ishte diskutuesi Vullnet Senaja, Drejtor Ekzekutiv i Anibarit. Ai tha se në përgjithësi buxheti për kulturën në Pejë është thënë se do të

zvogëlohet, mirëpo për skenën e pavarur do të rritet për 20 për qind, por prapë përderisa nuk ka kriterë të vendosura për shpërndarjen e këtyre mjeteve edhe kjo lë hapësirë për manipulime të mundshme. Ky rrjet i pavarur në Pejë hasë në vështirësi komunikimi me përfaqësuesit komunalë, të cilët kapen për numrat e përfaqësuesve të rrjetit. Në Pejë raportohet të ketë rreth 300 organizata aktive kulturore për të cilat ky rrjet i përbërë nga 9 organizata nuk ka njohuri. Veprimet e ardhshme të këtij rrjeti ndër të tjera do të jenë edhe organizimi më i mirë i brendshëm dhe gjithëpërfshirja e organizatave joqeveritare.

Në kontekst rajonal për shembull, Sllovenia është vendi i cili karakterizohet për struktura qeverisëse jashtëzakonisht të centralizuara. Komunat atje janë të fragmentuara dhe me shumë pak kompetenca vendimmarrëse, nuk kanë linja të ndara buxhetore dhe përkrahja qëi ndahet zakonisht iniciativave të pavarura është simbolike. Ministria e Kulturës ka bërë përpjeke që t'i centralizojë të gjitha komunat sllovene duke u kërkuar atyre strategji kulture. Ky projekt ka dështuar, sepse ato komuna nuk kanë qenë në posedim të stafit profesional, resurseve etj. Megjithatë situata në qendrat e mëdha si për shembull në Lubjanë qëndron ndryshe. Në këto qendra ekzistojnë institucione



të pavarura profesionale të kulturës dhe përkundër bashkëveprimit të tyre institucional me shtetin, ata vazhdojnë ta kritikojnë procesin. Selimovic, si pjesë e organizatës ASOCACIA, thotë se ata ende janë të patronizuar nga vendimmarrësit, projektet e tyre refuzohen, mbledhjet e përbashkëta janë formale ku qeveritarët i legjitimojnë vendimet që kanë marrë paraprakisht. Megjithatë, ata do të vazhdojnë të jenë pjesë e këtyre takimeve duke shpresuar që përmes kontributit të tyre do t'i ndërrojnë politikat kulturore. Institucionet e pavarura kulturore sllovene kanë tashmë përkrahje financiare permanente që konsiderohet sukses në raport me shtetet e rajonit dhe se përkundër faktit që përkrahja ka vazhduar të rritet kjo megjithatë nuk tregon shumë për përkrahjen që marrin nga shteti. Ajo në të cilën stagnon aktualisht skena kulturore sllovene u tha të jetë mungesa e kooperimit regional.

Kur përmenden politikat kulturore, a është menduar ndonjëherë dikush që është impakti i tyre në shoqëri? Pse është i rëndësishëm niveli lokal? Duke shtruar paraprakisht këto pyetje në konferencë, Violeta Simanjovska solli shembuj dhe përvoja të saja për t'u pasur parasysh nga skena kulturore kosovare. Ajo theksoi se impakti kryesor që ka kultura është

të përmirësuesjohë kualitetin e jetës tonë të përditshme, duke pyetur se a keni menduar ndonjëherë se janë pikërisht politikat kulturore ato që i bëjnë njerëzit lokalë të qëndrojnë në vendin e tyre dhe në të njëjtën kohë janë atraksion edhe për të tjerët. Ajo tha se në përpjekjen për të qenë atraktive një komunë duhet t'i përmbushë 5 kritere. E para është ndenja e sigurisë dhe kënaqësisë, që nënkupton se kur shkoni në një vend doni të ndiheni të sigurt, pastaj kualiteti i jetës kulturore, çfarë oferta lokale kemi në komunitat tona. Sipas saj janë ofertat kulturore ato që na nxisin të gjithë neve për të vizituar apo jo një vend. E treta janë industritë kreative, mediet dhe të tjerat, sepse ka shumë dinamikë në këtë sferë. Tutje vjen imazhi i qytetit, ku të gjithë do të duhej të kishin një vizion mbi atë që dëshirojnë ta kenë, dhe kjo nuk arrihet nga një person me rol politik, por nga të gjithë së bashku, theksoi Violeta. Jo më pak të rëndësishme janë edhe përgjegjësia dhe kapacitetet njerëzore. Njerëz që i udhëheqin këto procese kreative dhe gjithashtu i implementojnë këto politika kulturore dhe shumë i rëndësishëm është edhe kooperimi intersektorial. Për të ilustruar mendimet e saj ajo solli vizuelisht edhe shembuj të ndryshëm në qytete të ndryshme, të cilat pikërisht për shkak të politikave

kulturore janë ose jo vende tërheqëse për njerëzit. Ajo përmendi shembuj të qyteteve ish-industriale, hapësirat e të cilave janë shfrytëzuar për krijimin e hapësirave alternative për shfrytëzim nga njerëzit. Si shembull të keq e përmendi humbjen e luftës së komunitetit kulturor maqedonas ndaj strategjisë Shkupi 2014. Ajo porositi komunitetin kulturor për debate transparente dhe proaktive, të jenë katalizator, përveç të propozojnë ide edhe t'i pranojnë ato nga të tjerët, të kenë komunikim intersektorial, koordinim përbrenda qeverisë, dhe gjithëpërfshirje sociale sidomos grupet e marginalizuara dhe natyrisht politikat lokale duhet të jenë pjesë integrale e zhvillimit të qytetit.

Mungesa e strategjive dhe prioriteteve kulturore në përgjithësi i karakterizon edhe komunat, pra nivelin lokal të qeverisjes. Është Komuna e Prishtinës ajo po përpigjet që me intervenime të vogla në politikëbërje të bëjë ndryshime të mëdha. Komuna e Prishtinës konsideron se institucionet nuk i kushtojnë rëndësi sa duhet kulturës dhe në këtë aspekt ata kanë marrë hapa konkret. Kultura nga ta konsiderohet si diçka që duhet të jetë pjesë e jona që nga fëmijëria prandaj edhe kanë filluar me inkuadrimin e shkollave në aktivitete kulturore, ku u përmenden festivali 'Prishtina lexon' dhe 'Festa e Muzikës', si forma alternative të

inkuadrimit të fëmijëve në jetën kulturore. Hap tjetër i komunës është edhe krijimi i listës së objekteve komunale që nuk po përdoren, për t'i kthyer në qendra multimediale ku artistët do të kenë hapësirë t'i shfrytëzojnë këto qendra pa pagesë dhe në shkëmbim të kësaj ata të mbajnë ligjëratat të ndryshme, aktivitete të ndryshme me fëmijët nëpër shkolla. Kështu politika e Prishtinës përshtatet me këto shembujt e qyteteve që një kohë kanë qenë industriale, dhe komuna konsideron se ne kemi objekte që duhet t'u ruhet trashëgimia industriale dhe historia por t'i kthejmë në objekte të përdorueshme për kulturën. Një ndryshim radikal, është ndarja e drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sportit në drejtori të kulturës dhe atë të sportit. Drejtorja e Kulturës mund të tregojë se cilat janë nevojat e kulturës në qytet, a ka nevojë për sallë apo teatër por drejtorja e planifikimeve do t'i planifikojë dhe mbikëqyrë këto investime kapitale. Drejtorja do të zhvillojë dhe promovojë kulturën duke qenë e hapur për bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet kulturore qoftë publike qoftë të pavarura. Albert Heta tha se nëse prezantohet një plan i tillë që buxheti për kulturë është strukturuar, rritja është sekondare. Kjo ndarje për institucionet e pavarura dhe projekte, ky është ndërrim radikal në politika të kulturës. Ai po ashtu

tha se ideja e komunës së Prishtinës për dhënien në shfrytëzim të objekteve për artistët është abstrakte, sepse ata si individ nuk mund ta menaxhojnë, do të duhej t'iu jepeshin institucioneve të pavarura. Dhe në vend të krijimit të listës së artistëve do të duhej ndoshta të krijohet lista e institucioneve të pavarura, sepse këto të fundit pikërisht me artistë punojnë. Në anën tjetër pjesë e hulumtimit të tij ka qenë edhe Prizreni të cilin ai e konsideron të ketë politika të avancuara, atje kanë drejtori për turizëm, Prizreni kulturën e sheh si më multidiplinare, një pjesë e përkrahjes së aktiviteteve kulturore vjen edhe prej drejtorisë së turizmit. Në strategjinë zhvillimore të Prizrenit janë dy rekomandime, njëri është për të krijuar një këshill të kulturës tjetri për t'i blerë disa pajisje mobile për ngjarje të mëdha të kulturës dhe kjo e dyta është realizuar shumë. Apo përmendi edhe rastin e privatizimit të kinemasë nga DokuFesti dhe faktin se një institucion i pavarur në njëfarë forme e ka shpëtuar një investim, pra DokuFesti i ka dhënë funksion atij objekti që do të kishte mbetur pa përmbajtje.

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Pejë ka pasur aktivitet ku kandidatët për kryetar komune të Pejës kanë nënshkruar nga një deklaratë zotimi ku janë zotuar se do të përbushin disa nga pikat që kanë

ardhur nga shoqëria civile që merret me kulturën në qytetin e Pejës. Disa nga pikat e kësaj deklaratë kanë qenë përpilimi i strategjisë kulturore si dhe plani i veprimit të drejtoratit të kulturës, kalendari kulturor i qytetit të Pejës, përcaktimi i kritereve dhe komisioneve për grantet për organizatat e kulturës, rritja e buxhetit kulturor për skenën e pavarur si dhe hartimi i politikave kulturore për zhvillimin e turizmit kulturor. Në raporte ka të dala që edhe pse zyrtarët komunalë japin hapësirë të mjaftueshme të propozimeve të organizatave të rrjetit të kulturës ata shpeshherë janë edhe pengues të këtyre proceseve duke vepruar ngadalë dhe se as në Pejë kultura nuk është një ndër prioritetet e zyrtarëve komunalë. Prandaj ky rrjet duke gjetur mjete për të paraqitur problematikat komunale do të përpiqet të krijojë gjithëpërfshirje dhe për ta ngritur çështjen e kulturës.

Përkundër faktit që e konsideron si jashtëzakonisht të arrirë të gjithë progresin e administratës së re në Komunën e Prishtinës, ajo për të cilën u paraqit i brengosur Heta, por jo vetëm ai është frika e shndërrimit të komunës në operator kulturor. Kur komunat funksionojnë si të tilla, nuk e shfrytëzojnë potencialin por tentojnë të bëjnë vetë projekte në kulturë situata është problematike. Rasti është tash që komunat të jenë inteligjente,

jo sikurse qyteti i Lubjanës që është operator i fuqishëm kulturor dhe kjo nuk do të duhej të ndodhte. Komuna duhet të krijojë hapësirë që operatorët kulturorë të funksionojnë, theksoi ai. Ne diskutimin e hapur u tha sërish se komuna duhet të jetë më e hapur për të kërkuar ndihmë nga njerëz kompetentë, në përgjithësi jo vetëm në Prishtinë, që komunat të mos shndërrohen në operatorë kulturorë, por t'i ndjekin operatorët kulturorë. Komuna e Prishtinës u tha t'i ketë parasysh të gjitha këto dhe se kur deklarohen se kulturën duan ta ofrojnë më afër qytetarëve nuk i bie se komuna do të jetë ajo e cila do ta ofrojë kulturën por së bashku me artistët do të mundohet t'u krijojë vend atyre.

Spektori i pavarur kulturor konsiderohet dukshëm më kreativ, me performancë më të mirë ekonomike dhe në përgjithësi prodhon më shumë se sa sektori publik duke pasur efekt dukshëm më të madh në komunitet para se gjithash, por edhe në ekonomi. Edhe pse operatorët kulturorë, siç është rasti në Slloveni, e shohin përkrahjen e kulturës vetëm nga impakti i saj ekonomik u deklarua aktivisti Selimoviç.

Në diskutimin e hapur ndër të tjera u fol edhe për rolin e medieeve, mungesën e përfaqësuesve zyrtarë të medieeve si dhe mungesa e politikave të tyre redaktuese.

Gjithashtu për gjendjen jo të mirë të trashëgimisë kulturore si rezultat i mungesës së vullnetit politik, buxhetit të pamjaftueshëm në fushën e trashëgimisë kulturore, joprofesionalizmit e sidomos në nivelin komunal. U diskutua edhe për problemet e teatrove si publike ashtu edhe private ku u konstatua se ligji me anë të cilit ato janë lënë në kompetencë të komunave i ka bërë të vdekshme duke i shndërruar në teatro fiktive. Përfundimisht u konkludua se kultura duhet të masivizohet dhe të pushojë së qenuri vetëm kulturë elitare. Hapësirën duhet ta kenë të gjithë njëjtë qoftë në nivel shteti qoftë në atë komunal, por paraprakisht të vendosen kritere bazë.

# Rekomandimet

## **Bazuar në atë që është diskutuar në këtë konferencë në vijim janë rekomandimet e raportit:**

- Hartimi i strategjisë Kombëtare të Kulturës.

- Bashkëpunimet dhe koalicionet e përbashkëta mes institucioneve të pavarura të kulturës dhe pushtit qendror/ lokal në zhvillimin e politikave kulturore.

- Krijimi i platformave ndërsektoriale, multidisciplinare që mundësojnë shkëmbimin e ideve, që për fokus kanë praktikat artistike, që kanë për qëllim të provokojnë ndryshime pozitive shoqërore në kulturë.

- Të krijohet një sistem, një strukturë, një standard mbi të cilin bazohen analizat dhe hulumtimet për shpërndarjen e buxhetit dhe menaxhimin e parasë publike.

- Të bëhet reformimi i mënyrave të mbështetjes që marrin institucionet publike dhe institucionet e pavarura qoftë në nivel qendror qoftë në atë lokal. Të ketë përputhje në mes të inputeve dhe outputeve që këto institucione japin për ta mbajtur në nivel edhe cilësinë e kulturës se ofruar.

- Të krijohet lista e prioriteteve dhe pastaj të dihet se cilat organizata do të mbështeteshin nga Ministria e Kulturës.

- Të krijohet ligji që do të përcaktonte shpërndarjen e buxhetit në nivel lokal.

- Të lirohen nga TVSH apo të zbutet përqindja që institucionet e pavarura duhet t'i paguajnë shtetit atëherë kur pranojnë grante apo donacione nga të huajt

- Kompetenca për ndarjen e subvencioneve për kulturën do të duhej t'i takonte ministrisë së arsimit, aty ku ka njerëz të thirrur për ekspertizë të nevojshme dhe për të vlerësuar saktë se çka duhet mbështetur.

- Të merret shembulli i fondacionit Kultura Nova - Fondacion Publik për Zhvillimin e Kulturës Bashkëkohore për të krijuar partneritet publiko-shoqëror në nivel institucional.

- Të krijohet platforma gjithëpërfshirëse në përpjekje të reprezentimit të rrjetit të kulturës si diçka që jo vetëm kërkon përkrahje financiare nga shteti, por edhe e kundërshton atë fuqishëm kur vendimet që merr konsiderohen joadekuate dhe përtej kulturës prekin një shkallë më të gjerë shoqërore

- Të konsiderohet krijimi i një portali të skenave të pavarura kulturore të të gjithë rajonit, ku do të mund të ketë trafik, shkëmbime dhe fluks informacionesh duke ndërtuar kështu edhe një strategji të përbashkët rajonale për skenën kulturore.

- Të ndiqet shembulli i politikave të

reja kulturore në Komunën e Prishtinës ne idenë e ndarjes së drejtorive dhe buxheteve përkatëse në sektorë të caktuar.

- Të ketë thirrje të ndara për secilin sektor dhe të jenë të përcaktuara kriteret paraprakisht.

- Komuniteti kulturor të jetë i unifikuar në interesa të përbashkëta dhe të jetë gjithashtu proaktiv.

- Të ketë gjithëpërfshirje sociale sidomos grupet e marginalizuara.

- Politikaf lokale duhet të jenë pjesë integrale e zhvillimit të qytetit.

- Objektet e rifunksionalizuara në komunën e Prishtinës, por edhe në komuna të tjera t'u jepen në shfrytëzim institucioneve të pavarura e jo artistëve të cilët si individ nuk do ta menaxhonin dot punën.

- Të merret si shembull edhe nga qytetet e tjera deklarata e rrjetit të organizatave të Pejës dhe të bëhet presion që komuna të veprojë konform premtimeve që u ka dhënë atyre organizatave kur ka pranuar të jetë nënshkruese e deklaratës.

- Inkurajohet komuniteti artistik të gjejë mjete dhe forma inovative për të paraqitur problematikat komunale dhe të përpiqet të krijojë gjithëpërfshirje për ta ngritur çështjen e kulturës dhe për ta plasuar atë edhe tek masa më e gjerë e

shoqërisë

- Komuna të jenë më të hapura për të kërkuar ndihmë nga njerëz kompetent, në përgjithësi jo vetëm në Prishtinë, dhe të mos shndërrohen në operatorë kulturorë, por t'i ndjekin operatorët kulturorë dhe t'u krijojë hapësirë njerëzve kompetentë.

- Të rishikohet roli i medieeve dhe politikave të tyre redaktuese në raport me kulturën.

- T'i kushtohet më shumë rëndësi trashëgimisë kulturore.

- Të masivizohet kultura dhe të pushojë së qeni vetëm kulturë elitare, sepse impakti kryesor që ka kultura është të përmirësojë kualitetin e jetës tonë të përditshme.

# Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si Sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

## **Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:**

- Fuqizimit të organizatave të pavarura kulturore, duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e

programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,
- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,
- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

## **Forumi Kulturor synon të përmbushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:**

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës
- Shkëmbimi dinamik i informacioneve dhe përvojave
- Aktivitetet e lobimit dhe avokimit
- Trajnimet specifike për nevojat e organizatave anëtare
- Organizimi i debateve dhe forumeve
- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore.

# Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikave kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë, e bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.





Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë



Implementuar nga:





The image features a white background with a complex pattern of light blue lines and shapes. A vertical bar of a darker blue color runs along the left edge. The geometric elements include various triangles, rectangles, and lines that intersect to form a grid-like structure with some irregularities. Some of these shapes are filled with a light blue color, while others are just outlines. The overall aesthetic is clean, modern, and architectural.

*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*

